



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 127

Datë 12 gusht 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr. 517, datë 1.8.2014

Për kuotat e pranimit të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifat e shkollimit, për vitin akademik 2014 – 2015..... 5839

Vendim i KZHR
nr. 13, datë 6.8.2014

Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve..... 5847

VENDIM
Nr. 517, datë 1.8.2014

**PËR KUOTAT E PRANIMIT TË STUDIMEVE ME
KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË, NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE
JOUNIVERSITARE PROFESIONALE DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE
TË CIKLIT TË DYTË, SI DHE TARIFAT E
SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2014 -
2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 dhe 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimit të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2014 - 2015, në ciklin e parë të studimeve, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, janë 19726, të ndara, si më poshtë vijon:

- a) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimeve të ciklit të parë, për programet e studimeve jouniversitare profesionale, si dhe për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë 19166;
- b) Kuota për program të dytë studimi 200;
- c) Kuota për transferim studimesh 300;
- ç) Kuota për shtetasit e huaj 60.

2. Kuotat e pranimeve të reja, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij vendimi, përbëhen nga:

- a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit 18501;
- b) Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit 600;
- c) Kuotat për të verbrit 15;
- ç) Kuotat për romët dhe ballkano-egjiptianët 20;
- d) Kuotat për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë 15;
- dh) Kuotat për jetimët 15;

3. Kuotat e pranimit në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, të

përmendura në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimit për programet e studimeve të ciklit të parë, të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit, si Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje. Këto kuota shpërndahen me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë. Rishpërndarja e këtyre kuotave kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se data e parashikuar për fillimin e vitit akademik 2014 - 2015.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi dhe nga prefekturat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Kriteret e vlerësimit dhe të pranimit të tyre në këto programe studimi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe bëhen të njohura në median e shkruar e elektronike për të gjithë kandidatët e interesuar. Procedurat për procesin e përzgjedhjes dhe regjistrimit të kandidatëve fitues duhet të përfundojnë përpara fillimit të vitit akademik 2014 - 2015.

5. Kuotat e pranimit për të verbrit, të përcaktuara në shkronjën "c", të pikës 2, të këtij vendimi, për romët dhe ballkano-egjiptianët, të përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 2, të këtij vendimi, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuara në shkronjën "d", të pikës 2, të këtij vendimi, dhe për jetimët, të përcaktuara në shkronjën "dh", të pikës 2, të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve me statusin përkatës nga një komision me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit të përbashkët, si dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve përcaktohen me udhëzim të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

6. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, të përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nga personat e interesuar.

7. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, të vitit akademik 2014 - 2015, pasqyrohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Raste të përjashtimit apo reduktimit të tarifës së shkollimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit publik të arsimit të lartë si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin do të vazhdojë studimet.

9. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë, në vitin akademik 2014 - 2015, 3 (tre) studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Përjashtim bën Universiteti i Arteve të Tiranës, në të cilin tre studentët e vitit të parë, me rezultatet më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë – preferencë) në nivel fakulteti, nuk paguajnë tarifën vjetore të shkollimit.

10. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1 të këtij vendimi, si edhe kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, mbështetur edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

11. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit bëhen sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

12. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

13. Kandidatët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi.

14. Kandidatët, të cilët aplikojnë për një program të parë studimi në vitin akademik 2014 - 2015, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në: Universitetin e Arteve Tiranë, Universitetin e Sporteve të Tiranës, Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan (programi i studimit “Edukim fizik dhe sporte”), Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (programi i studimit “Edukim fizik dhe sporte”), si dhe

në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (programet e studimit të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën, FASTIP), duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta (përfshirë këtu konkurset e pranimit) të vendosura nga vetë këto institucione të arsimit të lartë.

Kriteret e veçanta për këto programe studimi duhet t’i plotësojnë edhe kandidatët që kërkojnë të studiojnë në një program të dytë studimi.

15. Studentët, që vijojnë një program të dytë studimi, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit, të përcaktuar në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

16. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të parë apo të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në programet respektive të studimit në institucionet publike të arsimit të lartë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare shtetërore janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

17. Pranimi i studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet nëpërmjet parimit meritë - preferencë dhe kryhet në dy raunde (aplikimi me dy formularët, A2 dhe A3):

17.1 Shpërndarja e fituesve në programe të ndryshme studimi, të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet në mënyrë të informatizuar, duke u mbështetur në rezultatet e shkollës së mesme, të Maturës Shtetërore (merita), si dhe të përzgjedhjes së programeve të studimit (preferenca), të bërë nga vetë kandidati/ja. Raundi i parë (aplikimi me formularin A2) zhvillohet në dy faza: Faza I, regjistrimi *on-line* dhe faza II, regjistrimi me dokumentacionet e kërkuara sipas udhëzimit përkatës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në sekretaritë e fakulteteve pranë institucioneve publike të arsimit të lartë, ku janë shpallur fitues.

17.2 Kuotat që mbeten të parealizuarra për çdo program studimi pas aplikimit me formularin A2 rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bazë të propozimeve të institucioneve publike të arsimit të lartë.

17.2.1 Në raundin e dytë kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë maturantët/kandidatët që kanë konkurruar në raundin e parë me të njëjtën renditje preferencash të atij raundi, me përjashtim të:

a) fituesve të preferencës së parë, të cilët janë regjistruar në këtë program studimi;

b) maturantëve/kandidatëve të cilët nuk kanë kërkuar vazhdimin e konkurrimit për preferenca më të larta gjatë regjistrimit *on-line* dhe që rezultojnë të regjistruar në programin e studimit të preferuar.

17.2.2 Formulari A3 përfshin programet e studimit të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë me kuotat respektive të paplotësuara të rishpërndara nga

Ministria e Arsimit dhe Sportit. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët, të cilët:

a) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, sesioni i parë, por nuk kanë plotësuar formularin A2;

b) kanë marrë pjesë dhe kanë rezultuar fitues në provimet e Maturës Shtetërore, në sesionin e vjeshtës 2014;

c) kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë Republikës së Shqipërisë dhe u janë ekuivalentuar rezultatet e shkollës së mesme dhe provimet e Maturës Shtetërore;

ç) kanë plotësuar formularin A1Z në sesionin e dytë (të vjeshtës) dhe rezultojnë kalues në provimet me zgjedhje.

18. Kuotat, që mbeten të porealizuara edhe pas regjistrimit të fituesve të shpallur nga aplikimi në raundin e fundit, nuk rishpallen.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, DAR/ZA-të dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

TABELA Nr.1. KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, NË PROGRAMET E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE, DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për program të parë studimi	Tarifa për program të dytë studimi
Universiteti i Tiranës	001	Histori	120	30.000	111.778
Universiteti i Tiranës	002	Gjeografi	120	30.000	111.778
Universiteti i Tiranës	003	Gjuhë - Letërsi	120	30.000	111.778
Universiteti i Tiranës	004	Gazetari	85	30.000	111.778
Universiteti i Tiranës	005	Arkeologji	40	30.000	111.778
Universiteti i Tiranës	006	Biologji	120	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	007	Bioteknologji	90	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	008	Matematikë	80	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	009	Fizikë	100	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	010	Informatikë	300	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	011	Kimi	80	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	012	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	90	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	013	Kimi Industriale dhe Mjedisore	90	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	014	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	120	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	015	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	200	25.000	203.690
Universiteti i Tiranës	016	Gjuhë Angleze	200	25.000	135.730
Universiteti i Tiranës	017	Gjuhë Frënge	120	25.000	135.730
Universiteti i Tiranës	018	Gjuhë Gjermane	125	25.000	135.730
Universiteti i Tiranës	019	Gjuhë Italiane	125	25.000	135.730
Universiteti i Tiranës	020	Gjuhë Greke	60	25.000	135.730
Universiteti i Tiranës	021	Gjuhë Turke	60	25.000	135.730
Universiteti i Tiranës	022	Gjuhë Ruse	60	25.000	135.730
Universiteti i Tiranës	023	Gjuhë Spanjolle me profil Gjuhë - letërsi dhe qytetërim hispanik	70	25.000	135.730
Universiteti i Tiranës	024	Psikologji	100	40.000	111.778
Universiteti i Tiranës	025	Punë Sociale	100	40.000	111.778
Universiteti i Tiranës	026	Filozofi	80	40.000	111.778
Universiteti i Tiranës	027	Sociologji	80	40.000	111.778
Universiteti i Tiranës	028	Shkenca Politike	80	40.000	111.778
Universiteti i Tiranës	029	Administrim dhe Politika Sociale	100	40.000	111.778
Universiteti i Tiranës	030	Administrim - Biznes	400	35.000	86.374
Universiteti i Tiranës	031	Ekonomiks	70	35.000	86.374
Universiteti i Tiranës	032	Financë	400	35.000	86.374
Universiteti i Tiranës	033	Informatikë Ekonomike	200	35.000	86.374
Universiteti i Tiranës	034	Drejtesi	600	40.000	63.341
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	035	Mjekësi e Përgjithshme	300	45.000	233.916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	036	Farmaci	90	45.000	233.916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	037	Stomatologji	60	45.000	233.916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	038	Shëndet Publik	20	40.000	233.916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	039	Infermieri e Përgjithshme	300	40.000	233.916

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRA MIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për program të parë studimi	Tarifa për program të dytë studimi
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	040	Mami	80	35.000	233.916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	041	Teknik i Lartë Laboratori	60	35.000	233.916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	042	Fizioterapi	60	35.000	233.916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	043	Logopedi	40	35.000	233.916
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	044	Imazheri	70	35.000	233.916
Universiteti Bujqësor i Tiranës	045	Menaxhim Agrobiznesi	103	35.000	86.374
Universiteti Bujqësor i Tiranës	046	Ekonomi dhe Politikë Agrare	73	30.000	86.374
Universiteti Bujqësor i Tiranës	047	Financë – Kontabilitet	102	30.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	048	Menaxhim i Turizmit Rural	70	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	049	Informatikë Biznesi	60	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	050	Ekonomiks i Aplikuar	60	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	051	Mbrojtje Bimësh	72	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	052	Hortikulturë	55	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	053	Prodhim Bimor	65	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	054	Zootekni dhe Biznes Blegtoral	75	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	055	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	56	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	056	Agromjedis dhe Ekologji	110	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	057	Inxhinieri Agrare - Agromekanizim	69	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	058	Teknologji Agroushqimore	80	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	059	Vreshtari - Enologji	60	25.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	060	Mbarëshkrim Pyjesh	65	30.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	061	Përpunim Druri	65	30.000	144.906
Universiteti Bujqësor i Tiranës	062	Mjekësi Veterinare	111	40.000	233.916
Universiteti Politeknik i Tiranës	063	Inxhinieri Ndërtimi	105	35.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	064	Inxhinieri Hidroteknike	90	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	065	Inxhinieri Mjedis	52	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	066	Arkitekturë (Arkitekt)	135	40.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	067	Arkitekturë (Urbanist)	85	40.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	068	Inxhinieri Gjeodet	50	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	069	Inxhinieri Elektrike (Automatizim i Industrië)	60	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	070	Inxhinieri Elektrike (Energjitikë)	60	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	071	Inxhinieri Mekatronike	60	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	072	Inxhinieri Fizike	60	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	073	Inxhinieri Matematike	60	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	074	Inxhinieri Mekanike	143	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	075	Inxhinieri Tekstile dhe Modë	60	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	076	Inxhinieri Materiale	56	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	077	Inxhinieri Ekonomike	85	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	078	Inxhinieri Gjeologjike	72	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	079	Inxhinieri Gjeoburimesh	90	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	080	Inxhinieri Gjeoinformatikë	72	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	081	Inxhinieri Gjeomjedis	72	25.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	082	Inxhinieri Elektronike	55	30.000	203.690
Universiteti Politeknik i Tiranës	083	Inxhinieri Informatike	55	30.000	203.690

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRA MIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuatat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për program të parë studimi	Tarifa për program të dytë studimi
Universiteti Politeknik i Tiranës	084	Inxhinieri Telekomunikacioni	55	30.000	203.690
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	085	Gjuhë - Letërsi	45	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	086	Gjuhë Angleze	40	20.000	135.730
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	087	Mësuesi për Arsimin Fillor	50	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	088	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	30	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	089	Histori - Gjeografi	60	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	090	Filozofi - Sociologji	50	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	091	Matematikë - Fizikë	20	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	092	Matematikë - Informatikë	28	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	093	Biologji - Kimi	50	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	094	Teknologji Informacioni	65	20.000	111.812
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	095	Infermieri e Përgjithshme	100	20.000	233.916
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	096	Mami (Infermier)	50	20.000	233.916
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	097	Administrim dhe Politika Sociale	75	20.000	233.916
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	098	Financë - Kontabilitet	100	20.000	86.374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	099	Menaxhim	77	20.000	86.374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	100	Administrim Biznesi në Marketing	24	20.000	86.374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	101	Administrim Biznesi në Turizëm	50	20.000	86.374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	102	Agroushqim	24	20.000	86.374
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	103	Agrobiznes	20	20.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	104	Gjuhë - Letërsi	98	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	105	Histori - Gjeografi	78	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	106	Gjeografi dhe Gjuhë Italiane	46	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	107	Gjuhë Angleze	93	25.000	135.730
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	108	Gjuhë Frënge	20	25.000	135.730
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	109	Gjuhë Italiane	44	25.000	135.730
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	110	Gazetari	54	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	111	Gazetari - Anglisht	54	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	112	Biologji - Kimi	90	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	113	Matematikë - Fizikë	64	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	114	Teknologjitë e Informacionit	80	25.000	203.690
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	115	Teknologji Laboratori (2 vjeçar)	40	25.000	194.264
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	116	Fizikë Kompjuterike	52	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	117	Matematikë Informatike	27	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	118	Infermieri e Përgjithshme	120	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	119	Infermieri - Mami	70	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	120	Fizioterapi	70	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	121	Logopedi	40	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	122	Imazheri	60	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	123	Teknologji Laboratori	40	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	124	Mësuesi për Arsimin Fillor	110	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	125	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	80	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	126	Edukim Qytetar	70	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	127	Punonjës Social	70	25.000	111.778

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRA MIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për program të parë studimi	Tarifa për program të dytë studimi
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	128	Filozofi - Sociologji	70	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	129	Psikologji	70	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	130	Edukim Fizik dhe Sporte	45	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	131	Administrim - Biznes	120	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	132	Financë - Kontabilitet	120	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	133	Ekonomia dhe e Drejta	120	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	134	Informatikë Ekonomike	120	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	135	Ekonomi Turizmi	60	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	136	Administrim Biznesi dhe Inxhinieri	60	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	137	Shkenca Juridike në Biznes	60	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	138	Shkenca Juridike në Sektorin Publik	60	25.000	86.374
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	139	Biologji - Kimi	23	20.000	203.690
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	140	Matematikë-Informatikë	10	20.000	203.690
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	141	Teknologji Informacioni	20	20.000	203.690
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	142	Infermieri e përgjithshme	70	20.000	233.916
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	143	Infermieri Mami	15	20.000	233.916
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	144	Histori - Gjeografi	42	20.000	111.778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	145	Gjuhë - Letërsi Shqipe	15	20.000	111.778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	146	Gjuhë Letërsi Angleze	15	20.000	135.730
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	147	Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek	15	20.000	135.730
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	148	Mësuesi për Arsimin Fillor	21	20.000	111.778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	149	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	21	20.000	111.778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	150	Kontabilitet - Financë	70	20.000	111.778
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë	151	Administrim - Publik	20	20.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	152	Gjuhë - Letërsi	113	25.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	153	Gazetari dhe Komunikim	53	20.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	154	Histori	113	20.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	155	Gjeografi	93	20.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	156	Matematikë	60	20.000	203.690
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	157	Fizikë	30	20.000	203.690
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	158	Informatikë	90	20.000	203.690
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	159	Biologji - Kimi	70	20.000	203.690
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	160	Infermieri e Përgjithshme	80	20.000	233.916
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	161	Infermieri (Mami)	80	20.000	233.916
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	162	Infermieri (Fizioterapi)	30	20.000	233.916
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	163	Mësuesi për Arsimin Fillor	70	20.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	164	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	60	20.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	165	Psikologji	60	25.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	166	Punë Sociale	60	25.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	167	Edukim Fizik dhe Sporte	65	20.000	111.778
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	168	Financë - Kontabilitet	105	20.000	86.374
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	169	Administrim - Biznes	105	20.000	86.374
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	170	Turizëm	80	20.000	86.374
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	171	Gjuhë Angleze	70	20.000	135.730

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRA MIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për program të parë studimi	Tarifa për program të dytë studimi
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	172	Gjuhë Italiane	42	20.000	135.730
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	173	Gjuhë Gjermane	20	20.000	135.730
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	174	Gjuhë Frënge	24	20.000	135.730
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	175	Drejtësi	200	25.000	63.341
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	176	Matematikë	20	20.000	135.730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	177	Shkenca Kompjuterike	46	20.000	203.690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	178	Teknologji Informacioni	60	20.000	203.690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	179	Informatikë	80	20.000	203.690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	180	Inxhinieri Navale	42	20.000	203.690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	181	Inxhinieri Mekanike	70	20.000	203.690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	182	Navigacion dhe Peshkim Detar	35	20.000	203.690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	183	Biologji	70	20.000	135.730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	184	Inxhinieri Elektrike	20	20.000	203.690
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	185	Administrim Biznesi	120	20.000	86.374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	186	Menaxhim Turizmi	107	20.000	86.374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	187	Ekonomiks	103	20.000	86.374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	188	Financë	192	20.000	86.374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	189	Kontabilitet	43	20.000	86.374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	190	Marketing	60	20.000	86.374
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	191	Mësuesi për Arsimin Fillor	78	20.000	135.730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	192	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	59	20.000	135.730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	193	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	95	20.000	135.730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	194	Gjuhë Angleze	93	20.000	135.730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	195	Gjuhë Italiane	46	20.000	135.730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	196	Histori - Gjeografi	66	20.000	135.730
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	197	Drejtësi	140	20.000	63.341
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	198	Infermieri e Përgjithshme	150	20.000	233.916
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	199	Infermier Mami	50	20.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	200	Administrim Biznesi	50	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	201	Menaxhim - Marketing	50	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	202	Shkenca Ekonomike	50	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	203	Financë - Kontabilitet	50	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	204	Bankë Financë	50	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	205	Menaxhim Hotel Restorant	50	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	206	Menaxhim Turizëm Kulturor	50	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	207	Menaxhim Turizëm Arkeologjik	50	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	208	Drejtësi	78	25.000	146.232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	209	Shkenca Politike	44	25.000	146.232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	210	Administrim Publik	44	25.000	146.232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	211	Politikë Ekonomike	44	25.000	146.232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	212	Marrëdhënie me Publikun	44	25.000	146.232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	213	Histori	44	25.000	146.232
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	214	Infermieri e Përgjithshme	47	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	215	Mami	28	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	216	Fizioterapi	38	25.000	233.916

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRA MIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për program të parë studimi	Tarifa për program të dytë studimi
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	217	Navigacion dhe Peshkim Detar	35	25.000	233.916
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	218	Teknikë Elektrike (2- vjeçar)	38	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	219	Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime (2- vjeçar)	38	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	220	Asistencë Stomatologji (2- vjeçar)	27	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	221	Menaxhim Ndërtimi (2- vjeçar)	38	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	222	Menaxhim Transporti (2- vjeçar)	38	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	223	Asistencë Ligjore (2- vjeçar)	30	25.000	63.341
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	224	Asistencë Administrative (2- vjeçar)	30	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	225	Teknologji Automobilah (2- vjeçar)	38	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	226	Teknikë e Rrjeteve Kompjuterike (2- vjeçar)	38	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	227	Informatikë Praktike (2- vjeçar)	28	25.000	86.374
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	228	Gjuhë Angleze	50	25.000	135.730
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	229	Mësuesi për Arsimin Fillor	50	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	230	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	50	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	231	Ekspert Procesi Formimi	50	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	232	Psikologji-Sociologji	50	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	233	Gjuhë Letërsi - Anglisht	50	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	234	Gjermanisht-Anglisht	50	25.000	111.778
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	235	Shkenca Kompjuterike	50	25.000	203.690
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	236	Sistemet e Informacionit	50	25.000	203.690
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	237	Teknologji Informacioni	50	25.000	203.690
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	238	Matematikë - Informatikë	50	25.000	203.690
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	239	Informatikë - Anglisht	50	25.000	203.690
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	240	Multimedia dhe Televizioni Dixhital	30	25.000	203.690
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	241	Menaxhim i Bankave (Program në Gjuhë Angleze)	18	25.000	29.680
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	242	Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Program në Gjuhë Angleze)	10	25.000	29.680
Universiteti i Arteve, Tiranë	243	Regji Filmi dhe Televizioni	8	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	244	Aktrim	10	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	245	Regji	8	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	246	Skenografi - Kostumografi	10	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	247	Koreografi	10	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	248	Pikturë	65	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	249	Skulpturë	10	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	250	Muzikologji	3	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	251	Kompozim	4	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	252	Dirizhim	2	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	253	Piano	8	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	254	Violinë	8	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	255	Violonçel	4	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	256	Violë	4	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	257	Kitarë	5	40.000	216.320

EMERTIMI I UNIVERSITETIT	ID e PROGRAMIT	EMERTIMI I PROGRAMIT	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit	Tarifa për program të parë studimi	Tarifa për program të dytë studimi
Universiteti i Arteve, Tiranë	258	Kontrabas	2	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	259	Flaut	3	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	260	Oboe	2	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	261	Klarinetë	3	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	262	Fagot	2	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	263	Korno	3	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	264	Trombë	3	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	265	Trombonë	3	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	266	Bastub	1	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	267	Kanto	8	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	268	Pedagogji Muzikore	7	40.000	216.320
Universiteti i Arteve, Tiranë	269	Fizarmonikë Klasike	2	40.000	216.320
Universiteti i Sporteve të Tiranës	270	Shkencat e Lëvizjes	100	35.000	233.916
Universiteti i Sporteve të Tiranës	271	Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe të Rekreacionit	100	35.000	233.916
Total			18.501		

VENDIM**Nr. 13, datë 6.8.2014****PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Financimin e projekteve në fushën e infrastrukturës vendore, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me burim financimi vlerat e përcaktuara në pikat 4 dhe 5, të vendimit nr. 12, datë 1.8.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë zhvillimore, projektet e të cilave miratohen për t'u financuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të paraqesin pranë sekretariatit përkatës teknik, në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, brenda 3 (tri) javësh nga data e publikimit të këtij vendimi, një kalendar me të gjitha afatet e prokurimit publik dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve (realizimit të investimit), për të vlerësuar realizimin e investimeve.

3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit të bëjnë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njësisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.

4. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programit të Zhvillimit, financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI**Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	Anëtar
Ministri i Financave	Anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar
Ministri i Kulturës	Anëtar
Ministri i Mjedisit	Anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar

Tabela 1. Projektet për financim të infrastrukturës vendore, thirrja e tretë

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (lekë)	Vlera për financim 2014	Vlera për financim 2015
Qarku Berat					
1	Komuna Gjerbës	Projekt zbatimi për rehabilitimin e sheshit të Komunës Gjerbës	7,718,369	6,174,695	1,543,674
2	Bashkia Çorovodë	Sistemim, asfaltim dhe ndricim i segmentit rrugor "Arkitekt Kasemi"	74,620,091	29,848,036	44,772,055
Qarku Durrës					
4	Bashkia Krujë	Rruga "Kalaja", Krujë: "Sistemimi dhe ndriçim i rrugës së malit të Krujës"	16,094,040	11,265,828	4,828,212
5	Bashkia Korçë	Restaurimi i pazarit të vjetër të Korçës, Loti 1, Loti 2	260,131,065	100,706,196	159,424,869
6	Komuna Udenisht	Sheshi Qendër-Udenisht, Rruga nacionale	30,000,000	15,000,000	15,000,000
Qarku Tiranë					
8	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rivitalizim urban i dy shesheve në Tiranë (1-Rehabilitimi i hapësirave urbane pranë Teatrit të Kukullave dhe lidhja me rrugën "Ibrahim Rrugova" ; 2-Rehabilitimi dhe sistemimi urban në hapësirën midis Ministrisë së Punëve të Brendshme, MZHUT, MTI, Teatrit Kombëtar dhe Teatrit të Komedisë)	90,650,000	36,260,000	54,390,000
Qarku Vlorë					
9	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstrukcion i urës Zvërnec	1,500,000	1,500,000	0
10	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërrhyrje për rehabilitimin urban dhe gjelbërimin përgjatë segmentit "Plepa në Durrës deri në Hyrje Vlorë"	120,501,750	48,200,700	72,301,050
11	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Supervizimi dhe kolaudim objekteve të financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	4,827,389	4,827,389	0
TOTALI			606,042,704	253,782,844	352,259,860

Shënim: 1.a "Vlera e plotë e projektit" përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoriteti kontraktues).

1.b "Vlera e financimit për vitin 2014" tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014.

1.c "Diferenca e financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2014 do të financohet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015".

2. "Objektet me autoritet kontraktues Bashkinë Korçë, FZHZH (projekti 8) si edhe Bashkinë Krujë, do të zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore".

3. Fondi për supervizim dhe kolaudim i bashkohet fondit të përcaktuar sipas pikës 2/c, të vendimit nr. 12, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, datë 1.8.2014. Fondi Shqiptar i Zhvillimit kryen detajimin e fondit për supervizim dhe kolaudim, për çdo objekt të miratuar për vitin 2014, sipas nevojës.

4. Projekti nr. 10, do të zbatohet në konsultim me Ministrinë e Mjedisit dhe me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi “Gjergj Fishta”, pas ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”,

Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006